



RAPORT MONITORIMI MBI SHKELJET E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE GJATË SITUATËS COVID-19



Save the Children



AVOKATI I POPULLIT



Suedi
Sverige



Save the Children



**Suedi
Sverige**

RAPORT MONITORIMI
MBI SHKELJET E TË DREJTAVE
TË FËMIJËVE GJATË SITUATËS
COVID-19

RAPORT MONITORIMI MBI SHKELJET E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE GJATË SITUATËS COVID-19

Eksperte dhe hartuese e raportit
Jonida Hoxha

Tiranë, 2020

Save the Children është organizatë kryesuese në botë dhe e pavarur për fëmijë. Ne besojmë se çdo fëmijë meriton një të ardhme të mirë. Në botë dhe në Shqipëri, Ne ndihmojmë fëmijët të kenë një fillim të mbarë në jetë, mundësi për të mësuar dhe mbrojtje ndaj cdo rreziku. Ne bëjmë më të mirën për fëmijët - çdo ditë dhe në kohë krize –për të sjellë ndryshime në jetën e tyre dhe të ardhmen e përbashkët.

Ky dokument u hartua dhe publikua në kuadër të projektit “Nga Fëmijët për Fëmijët”, i financuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar dhe zbatuar nga Save the Children në bashkëpunim me Zyrën e Avokatit të Popullit dhe Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

©Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret apo kopjohet lirisht prej specialistëve të fushës, por jo për qëllime fitimprurëse, me kusht që çdo riprodhim të shoqërohet me njohjen e organizatave, të përmendura më lart, si burim. Këndvështrimet e autores të këtij raporti jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Save the Children.

LISTA E SHKURTESAVE

RSH- Republika e Shqipërisë

AP - Avokati i Popullit

KMPDF- Komisioneri për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

SMPDF – Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

NJMF - Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës

PMF - Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës

Covid-19- Cov-Sars-19

KDF- Konventa për të Drejtat e Fëmijës

OBSH - Organizata Botërore e Shëndetësisë

MASR - Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

MSHMS- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

DPD- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

UNICEF - United Nations Children's Fund

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Termi pandemi është i njohur në shkallë globale pasi njerëzimit kohe pas kohe i është paraqitur sfida e përballjes me sëmundje të tilla, të cilat kanë një shkallë të gjerë transmetueshmërie me pasoja të rënda në shëndetin e popullatës.

Covid-19 ishte përballje që na sfidoi mbas pothuaj një shekulli që kur në Tokë u shfaq gripi spanjoll. Kjo gjendje pandemie e ndihmuar edhe nga zhvillimi i vrullshëm i lëvizjes nëpër botë, ka vënë në lëvizje gjithë mekanizmat mbrojtës të shteteve në funksion të daljes nga situata e pandemisë dhe rikthimin në jetën normale.

Masat e ndërmarra në pjesën më të madhe të vendeve kanë konsistuar në kufizimin ekstrem të së drejtës së lëvizjes brenda dhe jashtë vendit, lirisë së grumbullimit, zhvillimin e aktiviteteve sportive e kulturore, etj,

Është e rëndësishme të theksohet se masat e ndërmarra për të luftuar pandeminë e COVID-19, duhet të jenë në proporcion si me gjendjen e diktuar, ashtu edhe në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut, përfshi këtu edhe masat urgjente për mbrojtjen e shëndetit publik. Për këtë arsye, masat e marra për parandalimin e përhapjes së COVID-19, kanë shtruar pyetje të mëdha në lidhje me proporcionalitetin e tyre si dhe pasojat që sollën në gjithë sistemin e mbrotjes të të drejtave të njeriut në përgjithësi, e të fëmijëve në veçanti.

Ky raport do të paraqesë masat shtrënguese të ndërmarra nga qeveria Shqiptare në kuadër të pandemisë covid-19 si duke mbajtur në konsideratë:

- Aktet dhe organizimin institucional në kuadër të pandemisë;
- Pasojat që masat shtrënguese sollën si në mënyrë të drejtpërdrejtë, ashtu edhe indirekt, duke analizuar ndër të tjera edhe raste konkrete të paraqitura për trajtim tek institucioni i AP.

Qëllimi i këtij raporti është të analizojë impaktin e masave shtrënguese anti covid-19 me fokus tek të drejtat e fëmijëve. Gjithashtu edhe të paraqesë rekomandime të cilat vlerësohen të nevojshme në rast përsëritje të një situatë mbylljeje në të ardhmen.

Këto rekomandime i drejtohen institucioneve shtetërore përgjegjëse për menaxhimin e pandemisë dhe ato të përfshira në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në mënyrë që të minimizohen për aq sa është e mundur pasojat afatshkurtra dhe afatgjata që pandemia covid 19 do të sjellë tek fëmijët.

II - HYRJE

Më 11 Shkurt 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) zyrtarizoi emërtimin “COVID-19” për një sëmundje ngjitëse të re, e cila ishte raportuar si e shfaqur në qytetin Wuhan të Kinës në Dhjetor 2019. Duke parë shkallën e lartë të transmetueshmërisë si dhe pasojat e shkaktuara, më 11 mars, OBSH deklaroi, se shpërthimi i SARS-CoV-2 cilësohej si pandemi globale.¹ OBSH pohoi, se në gjashtë kontinentet ekzistonte një transmetim i vazhdueshëm i virusit, i cili deri në atë moment, kishte infektuar mbi 118 mijë njerëz dhe kishte shkaktuar vdekjen e rreth 4,300 personave.

Covid-19 rezultoi se trasetohet nga njeriu te njeriu, përmes kontaktit të drejtpërdrejt human (fizik) apo kontaktit indirekt (nëpërmjet sipërfaqeve/ objekteve të kontaminuara) ose spërklave të pështymës.

Parimet themelore të OBSH, për të zvogëluar rrezikun e përgjithshëm të transmetimit të infeksioneve akute të frymëmarrjes përfshinë masat e mëposhtme:

- Shmangien e kontaktit të ngushtë me njerëzit që vuajnë nga infeksione akute të rrugëve të frymëmarrjes.
- Laren e shpeshtë e duarve, veçanërisht pas kontaktit të drejtpërdrejtë me njerëzit e sëmurë ose mjedisin e tyre.
- Shmangien e kontaktit të pambrojtur me kafshët (qofshin ato shtëpiake apo të egra).
- Personat me simptoma të infeksioneve akute të rrugëve të frymëmarrjes duhet të praktikojnë higjienën respiratore të lidhur me kollën (ruajtja e distancës, mbulimi me shami/letër ose rroba kur teshtijnë apo kolliten, larjen e duarve).
- Brenda mjediseve të kujdesit shëndetësor, forcimi i praktikave standarde të parandalimit të infeksionit dhe kontrollit në spitale, veçanërisht në shërbimet e urgjencës.

Përballë kësaj emergjencë shëndetësore globale, shumica e vendeve të prekura ndërmorrën masa bllokuese, për të penguar përhapjen e saj, dhe për të lehtësuar presionin në sistemet e tyre shëndetësore. Kjo, në funksion të rritjes të kujdesit për pacientët e prekur seriozisht nga sëmundja dhe për njerëzit e tjerë, që mund të kishin nevojë për kujdes nga sistemi shëndetësor.

1. Pandemia është një sëmundje që përhapet në shumë vende të botës në të njëjtën kohë. Një pandemi sipas fjalorëve epidemiologjikë është një epidemi që ndodh në gjithë botën në të njëjtën kohë apo në një zonë shumë të madhe gjeografike që tejkalon kufijtë ndërkombëtarë dhe që zakonisht prek një numër të madh njerëzish. Një sëmundje pandemike është e ndryshme nga një shpërrthim sëmundjeje dhe termi më shumë i referohet sesa vende në botë po luftojnë me të në një nivel të lartë sëmundshmërie dhe nuk lidhet me seriozitetin e saj.

Fëmijët që kanë kontakt me COVID-19 duket se zhvillojnë simptoma më të lehta dhe kanë raport fataliteti të ulët në krahasim me të tjera grupmosha. Por, në pikëpamje më të gjerë të masave anti COVID-19, kriza duket se po sjell efekte negative afatgjata te fëmijët në disa aspekte të jetës së tyre.

Deri në hartimin e këtij raporti është raportuar se nivelet e infeksionit të Covid-19, nuk kanë sjellë pasoja të rënda shëndetësore tek fëmijët, por efektet më të gjera të krizës në shëndetin e fëmijëve janë domethënëse.

Ajo që vihet re është se familjet të cilat kanë vështirësi në sigurimin e një pune, ose që nuk kanë të ardhura të mjaftueshme, janë të detyruara të minimizojnë shpenzimet thelbësore të shëndetit dhe ushqimit, gjë që prek veçanërisht fëmijët.

Human Rights Watch raporton se, gjatë aplikimit të masave shtrënguese në periudhën Mars-Maj 2020, më shumë se 1.5 bilion nxënës ndërprejnë shkollat dhe humbja e punës së prindërve si dhe e të ardhurave familjare, kombinuar me pasigurinë ekonomike me gjasa do të rrisin nivelet e shfrytëzimit të fëmijëve, shtatzani të adoleshenteve, abuzim seksual si dhe të martesës në moshë të mitur. Stresi i familjeve në izolim karantine, mbylljet e detyruara si dhe kufizimet e lirisë së lëvizjes mund të rrisin rastet e dhunës në familje².

II.1 Masat kryesore të ndërmarra në nivel kombëtar në Shqipëri.

Më 15.3.2020, qeveria miratoi aktin normativ me fuqinë e ligjit Nr. 3, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga covid-19”.

Të gjithë shtetasit e RSH-së u detyruan të kufizojnë lëvizjen brenda fashave orare të përcaktuara, duke realizuar ndalimin e lëvizjes së këmbësorëve në zonat urbane pas orës 18:00, me përjashtim të rasteve kur ishin të pajisur me autorizim për të lëvizur ose kishin një emergjencë shëndetësore³. Kjo u mundësua nëpërmjet përcaktimit dhe forcimit të zbatimit të rregullave, të vendimeve, të urdhrave dhe të udhëzimeve të nxjerra nga organet kompetente, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, për parandalimin dhe luftimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID19⁴.

Me qëllim ruajtjen e jetës dhe shëndetit të çdo të mituri të RSH-së, në funksion të interesit më të lartë të fëmijëve, me urdhër të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, u kërkua marrja e masave për ndërprerjen e procesit mësimor për një periudhë 2- javore në të gjitha institucionet arsimore publike dhe jopublike, me qëllim parandalimin e përhapjes së COVID-19⁵. Po kështu,

2. COVID-19 and Children’s Rights, Human Rights Watch, April 9, 2020.

3. Pika 1, e urdhërit nr.177/1, datë 16.3.2020, i ministrit të Shëndetsisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për kufizimin e lëvizjes, në zonat urbane”.

4. Akti normativ nr. 3, datë 15.3.2020, i Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”.

5. Urdhër 591, datë 9.3.2020, të ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë “Për ndërprerjen e procesit mësimor në të gjitha institucionet arsimore publike dhe jopublike”.

për shkak të mbylljes së çerdheve dhe të institucioneve arsimore, ndërmjet datave 10 dhe 23 mars 2020, u caktua ditë pushimi për njërin nga prindërit kujdestarë të fëmijëve, që frekuentojnë/ndjekin ose jo çerdhet, arsimin parashkollor dhe arsimin bazë, që janë nëpunës civilë dhe punonjës të tjerë të administratës publike, të nivelit qendror e vendor, si dhe në institucionet e tjera shtetërore⁶.

Ndërprerja e procesit mësimor u shoqërua me udhëzues për mësimin në kushtet e shtëpisë, për shkak të situatës së krijuar nga përhapja e Covid-19. Ky udhëzues specifikonte, se mësimi në kushtet e shtëpisë kishte për qëllim t'i mbante nxënësit të angazhuar me përmbajtjen lëndore dhe të përforconte njohuritë e fituara deri në atë moment, e për të mos u shkëputur nga procesi i të nxënësve, deri në rifillimin e procesit të rregullt mësimor.

Institucionet arsimore, çerdhet dhe kopshtet, publike dhe jopublike, mbyllen aktivitetin e tyre për periudhën e përcaktuar nga autoritetet kompetente. Në rast mosrespektimi, ndaj këtyre subjekteve vendosej masa e dënimit gjorbë deri në mbylljen e veprimtarisë, për një periudhë 6-mujore. Gjithashtu, me gjorbë dënoheshin subjektet apo individët, publikë apo privatë, që zhvillonin aktivitete në mjediset e mbyllura të argëtimit për fëmijë e të rinj, palestrat, qendrat sportive, pishinat, qendrat e internetit e qendrat kulturore, që nuk zbatonin urdhrin e organit kompetent për mbylljen e tyre⁷.

Për shkak të situatës së krijuar si rezultat i pandemisë COVID-19, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nisi punën për përshtatjen e masave organizative të mësuarit në distance, nëpërmjet prodhimit të materialeve mësimore në televizionin publik shqiptar (RTSH shkolla)⁸.

Qëllimi i kësaj praktike ishte të krijonte vazhdimësinë e të nxënësve po aq cilësor në mjediset shtëpiake. Nxënësve u ofruan vitin shkollor nëpërmjet platformave digjitale si dhe duke krijuar grupe të përbashkëta "whatsapp" mes nxënësve dhe stafit pedagogjik, gjithashtu duke përdorur mjetet e teknologjisë së informacionit.

6. Pika 1, e vendimit, nr.208, datë 10.3.2020, të Këshillit të Ministrave "Për caktimin e datave 10 deri 23 mars 2020 ditë pushimi për prindin kujdestar të fëmijëve të mitur".

7. Pika 5 dhe 6, e aktit normativ, nr.3 datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19",

8. Për realizimin e këtij procesi aspak të thjeshtë, UNICEF po mbështet financiarisht dhe teknikisht MASR për ofrimin e mësimin në distancë përmes platformës akademi.al. Platforma do të ketë një akses edhe më të gjerë për nxënësve duke përfshirë dhe parashkollorët.

III- METODOLOGJIA

Ky raport monitorimi është realizuar në kuadër të projektit “Të mbajmë fëmijët të sigurtë”, i cili financohet nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar(SIDA) dhe zbatohet nga Save the Children në bashkëpunim me institucionin e Avokatit të Popullit.

Me qëllim analizimin sa më objektiv të shkeljes të të drejtave të fëmijëve në kuadër të gjendjes Covid-19, ky raport do të fokusohet në pasqyrimin dhe shqyrtimin e akteve ligjore e nënligjore të miratuara pas shpalljes së gjendjes së pandemisë në RSH, në këndvështrim të të drejtave të fëmijëve, të sanksionuara në ligjin nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” si dhe Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës.

Gjithashtu, ky raport do të marrë në konsideratë të dhënat e përfutuara nga Save the Children në raportin e vlerësimit të nevojave të komuniteteve për shkak të impaktit të masave shtrënguese anti-covid⁹ nëpërmjet sondazheve të drejtuar fëmijëve të përzgjedhura me kampionim si dhe pyetësorët e drejtuar prindërve të tyre.

Raporti analizon rastet specifike të trajtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit gjatë masave shtrënguese anti-covid, duke e ndarë problematikën e hasur në varësi të së drejtës së cënuar.

Në këtë kuadër, është e rëndësishme të theksohet se, edhe pse disa raste janë referuar të AP apo janë pasqyruar në media në kuadër të shkeljes të një të drejte të caktuar, raporti analizon edhe pasojën që shkelja e saj mund të ketë pasjellë në privimin e fëmijëve nga disa të drejta të tjera, të cilat ligji ua njeh.

Elementët që janë mbajtur në konsideratë për t’u analizuar:

- përmbajtja rastit të referuar dhe e drejta konkrete që është paraqitur si e cënuar;
- planifikimi i SMPDF në drejtimin e shqyrtimit të rastit dhe ndjekjes së tij;
- aktivizimi i mekanizmave koordinues institucionalë dhe strukturave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës;
- dokumentimi i plotë i çështjeve të referuara; cilësia e burimeve informative;
- monitorimi i rasteve mbas referimit të tyre në strukturat përgjegjëse për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

9. <https://albania.savethechildren.net/sites/albania.savethechildren.net/files/library/Assessment%20Report%20on%20the%20effects%20of%20covid%2019%20to%20community.pdf>


Ky raport përmbledh gjetjet, përfundimet dhe sugjerimet parë nën një këndvështrim objektiv dhe të paanshëm, të udhëhequr nga fryma e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit me strukturat përgjegjëse për monitorim, në respekt të vështirësive me të cilat janë përballur institucionet shqiptare gjatë gjendjes së pandemisë.

IV- ANALIZA E RASTEVE TË TRAJTUARA NGA AP

KMPDF dhe SMPDF në institucionin e Avokatit të Popullit, gjatë periudhës së masave shtrënguese anti-covid, ka trajtuar 36 (tridhjetë e gjashtë) raste. Në raport me shpërndarjen gjeografike rezulton se rastet e referuara për trajtim janë të shpërndara në pothuaj gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë¹⁰.

Reagimi institucional i AP rezulton i shpejtë në raport me rastet e paraqitura dhe masat e kufizuara në lëvizje që vetë ky institucion ka pasur. Si institucion monitorues dhe këshillues, AP ka adresuar rastet te institucionet përgjegjëse për kujdesin dhe zgjidhjen e problematikave të trajtuara, në funksion të interesit më i lartë të fëmijës.

Interesi më i lartë i fëmijës nënkupton, të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën.



10. Kamez- 2; Durres-2;Gramsh- 2;Vlore-1;Librazhd-1;Tirane -6;Maliq-2;Kukes-1;Maminas-1;Perrenjas-1; GJinar/Elbasan-1;Kruje-2;Fier-3;Shkoder-1;

Siç vihet re nga tabela e mësipërme,

- 9 raste rezultojnë që janë zgjidhur me ndërmjetësimin e AP;
- 20 (njëzet) rezultojnë të jenë në trajtim ndërinstitucional nëpërmjet AP dhe institucioneve përgjegjëse për trajtimin e drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshëm të rastit;
- 7 (shtatë) raste rezultojnë që të jenë në trajtim në AP, që është edhe faza paraprake e ndjekjes së problematikës së paraqitur¹¹.

IV-I E drejta e jetës dhe përfitimit nga shërbimi shëndetësor¹².

Një ndër aktet i para të ndërmarrë në kuadër të infeksionit Sars-Covid 19 në Republikën e Shqipërisë rezulton të mbajë datën 24.2.2020. Me këtë datë Ministri i Shëndetësisë ka miratuar urdhrin nr.105 “Për marrjen e masave higjieno-sanitare për parandalimin e infeksioneve akute respiratorë përfshirë edhe Covid-19 në institucionet parashkollore, kopshte dhe çerdhe dhe institucione te tjera arsimore”. Masat e propozuara në këtë urdhër, përfshinin ndër të tjera, marrjen e masave për sigurimin e higjienës dhe materialeve higjienizuese në ambientet e frekuentuara nga grumbullime fëmijësh.

Me urdhrin nr. 147, datë 9.3.2020, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, pezulloi ndërhyrjet kirurgjikale të planifikuara në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi”.

Ndërsa, në kuadër të legjislacionit mbi mbrojtjen e fëmijëve u miratua udhëzimi nr. 253, datë 10.4.2020, i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje gjatë periudhës të fatkeqësisë natyrore për arsye të epidemisë së shkatuar nga COVID-19”. Ky udhëzim shërbeu si mjet procedural efektiv në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë gjatë periudhës së masave anti-covid-19 nga ana e institucioneve të ngarkuara me ligj për këtë detyrë.

Nga raporti i vlerësimit i kryer nga organizata Save the Children dhe MEDPAK, në muajin Maj 2020¹³, u vu re se, në grupet e intervistuar, 35% e personave me aftësi të kufizuara nuk mund të kishin akses në shërbim të përshtatshëm shëndetësor për shkak të masave kufizuese anti-covid të imponuara.

Gjithashtu, 40% e të anketuarve pohuan se, masat shtrënguese ishin pengesa kryesore e aksesit të tyre në shërbimet shëndetësore. Ndërsa, një pjesë e mirë e të anketuarve (24%) referuan mungesën e lëvizjes nëpërmjet transportit urban ndërqytetas si dhe mungesën e aftësisë paguese për të marrë shërbimin nga operatorët ekonomik të licensuar (taksi).

Avokati i Popullit ka trajtuar 4 (katër) raste që lidhen me cënimin e të drejtës së jetës dhe asaj për kujdes shëndetësor, gjatë periudhës së aplikimit të masave shtrënguese Mars-Qershor

11. Të dhënat e muajit Korrik 2020.

12. Neni 7 dhe neni 21 I ligjit nr.18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”

13. RAPID NEED ASSESSMENT for the situation created in Albanian communities as result of COVID 19

2020. Të gjithë rastet janë trajtuar dhe ndjekur nga KMPDF në lidhje me zgjidhjen e tyre të strukturat përgjegjëse për NJMF.

Me gjithë vështirësitë e hasura nga të gjithë institucionet shqiptare të cilat përshtatën metodat e përditshmërisë normale në një kontekst pandemie globale, AP ka trajtuar dhe adresuar tek institucionet përkatëse rastet e referuara dhe duke ndjekur në vijueshmëri edhe masat e ndërmarra për zgjidhjen e problematikave të raportuara.

IV-II E drejta për arsim

Arsimimi vlerësohet si e drejtë e njeriut në vetvete dhe si mjet i domosdoshëm për realizimin e të drejtave të tjera. Një sistem arsimor që bazohet në të drejta plotëson më mirë misionin e tij për arsimim cilësor për të gjithë.

Neni 26 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut:

- Çdo individ ka të drejtë për arsimim. Arsimi duhet të jetë i lirë, të paktën, arsimi fillor dhe ai bazë. Arsimi fillor duhet të jetë i detyruar. Arsimi teknik dhe profesional duhet të mundësohet në shkallë të gjerë dhe arsimi i lartë duhet të jetë njëlloj i mundshëm nga të gjithë, në bazë të meritës.
- Arsimi duhet t'i shërbejë zhvillimit të plotë të personalitetit njerëzor dhe rritjes së respektit për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore. Ai duhet të zhvillojë mirëkuptimin, tolerancën dhe miqësinë ndërmjet të gjitha kombeve, racave dhe grupeve fetare dhe të çojë më tej veprimtaritë e Kombeve të Bashkuara për ruajtjen e paqes.
- Prindërit duhet të kenë përparësinë në të drejtën për të zgjedhur llojin e arsimimit për fëmijët e tyre.

Gjithashtu, neni 28 i KDF, si zgjerim i disa prej ideve të shprehura në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (DUDNJ), e përcakton arsimin si një të drejtë, ndërsa neni 29, komenton që arsimi duhet të ndihmojë fëmijën në zhvillimin e plotë të “personalitetit, talenteve dhe aftësive të tij mendore e fizike”.

Mbyllja e institucioneve arsimore për shkak të masave parandaluese anti Covid-19 pasoi një sërë sfidash e vështirësish nga ana e të gjithë aktorëve të përfshirë në këtë proces. Këtu përfshihen fëmijët, mësuesit dhe prindërit e fëmijëve.

Ministria E Arsimit, Sportit dhe Rinisë më 30 Mars 2020, publikoi “Udhëzuesin e përditësuar për mësimin në kushtet e shtëpisë, për shkak të Situatës së krijuar nga përhapja e Covid-19”.

Ky udhëzues kishte për qëllim të orientonte mësuesit në punën e tyre për zhvillimin e mësimin në kushtet e shtëpisë, përtej fazës fillestare dyjavore të mbylljes së shkollave për shkak të Covid-19. Gjithashtu, udhëzuesi përfshinte shtojcën “Materiale dhe platforma për mësimin online” e cila përmbante modele testesh për provimet kombëtare, platforma online si dhe video tutoriale, të cilat mbështesin mësuesit në punën e tyre.

Referuar raportit të vlerësimit të kryer nga organizata Save the Children dhe MEDPAK, në muajin Maj 2020 “ vihet re se fokusi i familjeve dhe mësuesve në mundësimin e mësimeve online ka qënë maksimal. Kjo pasqyrohet në të dhënat e mbledhura nga prej rezulton se 83% e fëmijëve mund të aksesonin mësimet online.

Gjithsesi, për pjesën e mbetur, raportohet se problematika më e madhe e hasur në kryerjen e mësimeve në distancë ka qënë mungesa e aksesit në internet (80%).

Nga ana tjetër 26% e të intervistuarve pohuan se arsyeja kryesore në mos realizimin e mësimeve online ka qënë mungesa e kapaciteteve të shkollave për të ofruar mësimin online

Përjashtim nga të dhënat e mësipërme përbëjnë rastet e komunitetit rom në Shqipëri. Të dhënat e mbledhura tregojnë se përtej mungesës së pajisjeve apo mundësive për të aksesuar platformat e mësimet online¹⁴, vetëm 19% e fëmijëve Rom mundën të ndjekin mësimet përgjatë gjendjes së aplikimit të masave shtrënguese anti-covid-19.

Nga ana e SMPDF në periudhën e përfshirë në këtë raport monitorimi janë trajtuar 17 raste që lidheshin me të drejtën e fëmijës për t’u arsimuar. Rastet janë referuar nga vete personat apo edhe ndjekur me iniciative nga ana e SMPDF.

Shumica e rasteve të referuara kanë për objekt kryesor problematika të karakterit ekonomik dhe social, ndërsa mungesa e aksesit të fëmijëve në mësimdhënien online sipas platformave të paraqitura nga MAS, referohet si pasojë e mungesës së të ardhurave bazë, për të mundësuar ndjekjen e mësimeve nëpërmjet platformave online.

Nga të dhënat e paraqitura rezulton se KMPDF ka ndërmarrë rol aktiv duke angazhuar dhe nxitur institucionet përgjegjëse për të asistuar këto raste bazuar në problematikën sociale mbi të cilën ishin referuar por edhe për të zgjidhur problematikën e aksesit në mësimdhënie.

Referuar të dhënave të përfituara nga anketimi i “NEED ASSESSMENT for the situation created in Albanian communities as result of COVID 19 Save the Children and MEDPAK” rezulton se, aksesimi i mësimdhënies online nga grupet e fëmijëve me aftësi të kufizuara është edhe më i ulët se në gjithë kategoritë e tjera. Konkretisht, të dhënat tregojnë se edhe pse 76% e familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuara kanë një telefon smartphone vetëm 10% e tyre përdoren për përgatitjen e detyrave të shtëpisë së fëmijës.

Duke përllogaritur që 14% e totalit të fëmijëve me aftësi të kufizuara nuk kanë një telefon në familje, rezulton se më shumë se ¾ e këtyre fëmijëve nuk mundën të aksesonin mësimet online.

Të dhëna më të plota në lidhje me numrin e fëmijëve të ciklit të ulët (nga klasa e parë deri të pestën) të cilën ishin në pamundësi për të ndjekur mësimet nëpërmjet platformave online i gjejmë në të dhënat e pasqyruara nga MASR më 31 Gusht 2020.

14. ¾ of Roma Parents/caregivers find difficult to identify at least one mode to facilitate their children’s access to lessons, because they lack the appropriate communication means, as figure 49 demonstrates. Only 16% of Roma children can access online lessons, 10% can access TV lessons, while for the rest, it seems difficult to identify. Among other parents and caregivers, the picture is more optimistic, due to the 83% of children who can access online lessons.

Disa shkolla filluan mësimin për një total nxënësish prej 4500 fëmijëve kryesisht në zonat e Hasit, Kukësit dhe Tropojës¹⁵ por edhe për fëmijët e komunitetit rom apo egjiptian si dhe fëmijët e shtresave në nevojë të cilët ishin në pamundësi për të ndjekur mësimet nëpërmjet metodave online.

Nga analizimi i rasteve të trajtuara nga AP vihet re se cënimi i të drejtës për arsimim në kuadër të proceseve të modifikuara shkollore për t'u përshtatur me masat anti-Covid-19, pjesën dërrmuese të rasteve lidhej me pamundësinë ekonomike të familjeve për të patur akses në internet, pajisje elektronike por jo vetëm.

Përveç rasteve të karakterit individual të ndjekura, nga AP janë trajtuar edhe çështje të karakterit të përgjithshëm që lidheshin me cënimin e të drejtës për arsimim të fëmijëve në kontekst më të gjerë.

1. Fëmijët e ndodhur në zona të largëta

Kjo ndërhyrje synonte të sillte në vëmendjen e institucioneve përgjegjëse evidentimin e problematikës në masë të gjerë dhe adresimin të MASR të rekomandimeve të cilat mund të përmirësonin gjendjen e fëmijëve të ndodhur në zona të largëta në raport me ndjekjen e mësimave nëpërmjet platformave apo mënyrave të tjera të kryerjes së tyre apo të realizimit të testeve të lëndëve.

2. Mungesa e aksesit të maturantëve në transportin publik

Rasti i dytë adresonte problematikën e mungesës së aksesit në transport publik të maturantëve të cilët për shkak të largësisë nuk arrinin dot të ndiqnin klasat e dedikuara. Duke e konsideruar si një cënim të të drejtës për arsimim, AP ka hartuar rekomandime të cilat i janë drejtuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrisë së Drejtësisë dhe Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, për rishikimin e planeve shtrënguese në raport me këtë kategori nxënësish. Më konkretisht, është hartuar rekomandim për ndryshim legjislativ për të garantuar të drejtën e fëmijës për t'u arsimuar” me objekt: *rishikimin e vendimit nr.682, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimor që punojnë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, me qëllim përfshirjen e nxënësve të arsimit të mesëm të lartë në përfitimin e transportit falas nga fondet publike, si një e drejtë kushtetuese, për t'u garantuar kështu, kësaj kategorie ndjekjen dhe frekuentimin e arsimit të mesëm të përgjithshëm, pa barriera dhe diskriminim.*

3. Procedura e çdoganimit të 1000 pajisjeve tablet të dhuruara nga filantropi Destani

Rasti i tretë rezultoi të ishte aktivizimi i Avokatit të Popullit në komunikim të vazhdueshëm me MASR dhe DPD për lehtësimin e procedurave të çdoganimit të 1000 pajisjeve tablet të dhuruara nga filantropi Destani, me qëllim shpërndarjen te familjet në nevojë për kryerjen e procesit mësimor të fëmijëve të tyre. Këto pajisje edhe pse dhurate për MASR ishin bllokuar nga autoritetet doganore për shkak të mospagesës së tarifave përkatëse.

15. Në Has janë hapur 18 shkolla dhe kanë filluar mësimin 234 nxënës nga klasa e parë deri në klasën e pestë. Në Tropojë janë hapur 5 shkolla me 500 nxënës dhe në Kukës rreth 35 nxënës.


4. “Mbrojtja e fëmijëve/nxënës të arsimit parauniversitar gjatë procesit të mësimin online”

Institucioni i Avokati i Popullit, në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, ka hartuar rekomandimet e mëposhtme, të cilat ua ka adresuar institucioneve shtetërore përgjegjëse si: Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Sekretariatit të Përgjithshëm dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Më konkretisht, Avokati i Popullit ka rekomanduar:

- Rishikimin e kuadrit ligjor ekzistues në fushën e arsimit parauniversitar e më gjerë, për parashikimin e ngritjen e platformave të studimit *online*, si një prej formave kryesore të të nxënës, sot në epokën digjitale.
- Forcimin e punës për përsosjen e marrëdhënieve mësues-fëmijë/nxënës: marrëdhënie bashkëpunimi për arritjen e realizimit të objektivave të përbashkëta, ku një ndër të rëndësishmit është edhe parandalimi i çdo forme shkeljeje të të drejtave të tyre, edhe në këtë periudhë të pazakontë pandemie.
- Forcimin e sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të respektimit të të drejtave të fëmijëve dhe vendosjen e të drejtave të fëmijëve në zemër të vullnetit e të procesit të mësimdhënies.
- Aplikimin e një metodologjie të pedagogjisë e didaktikës, të bazuar në të drejta, për të siguruar, që fëmijët dhe të rinjtë, të mësojnë në një mjedis ku respektohen këto të drejta.
- Marrjen e masave nga MASR, gjatë procesit të të mësuarit *online*, për dhënien e informacionit të saktë dhe fakteve të bazuara në shkencë rreth COVID-19, për t'i ardhur në ndihmë fëmijëve në zvogëlimin e frikës dhe ankthit rreth sëmundjes, duke i mundësuar të përballojnë çdo efekt apo ndikim që do të ketë ky virus në jetën e tyre. Transmetimet *online* duhet t'u ofrojnë nxënësve informacion jetik për pastrimin e duarve dhe masave të tjera për të mbrojtur veten, të ofrojnë mbështetje për shëndetin mendor, t'i ndihmojnë nxënësit të jenë të sjellshëm ndaj njëri-tjetrit dhe të shmangin stereotipet kur flasin për virusin.
- Marrjen e masave, për organizimin e procesit të mësimdhënies në televizion, edhe në gjuhën e shenjave, duke i ardhur në ndihmë fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Cënimi i të drejtës për arsimim



- vështirësi ekonomike
- mungesë dokumentacioni për dy vite të ndjekura jashtë vendit
- bllokimi jashtë vendit për shkak të masave shtrënguese
- të tjera

Siç mund të analizohet nga tabela e mësipërme 70 % e rasteve të trajtuara në kuadër të cënimit të së drejtës për arsim lidhet me mungesën e kushteve minimale ekonomike për të jetuar.

IV-III E drejta për të përfituar nga shërbimi i kujdesit shoqëror

E drejta për të përfituar nga shërbimi i kujdesit shoqëror është sanksionuar në nenin 22 të ligjit nr.18/2017. Ky nen parashikon se fëmijës i garantohet e drejta të përfitojë nga shërbimi i kujdesit shoqëror, drejtpërdrejt apo nëpërmjet prindit ose kujdestarit të tij, sipas legjislacionit në fuqi për shërbimet e kujdesit shoqëror. Në rast se prindi/prindërit ose personi/ personat që kujdesen për fëmijën nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, për shkak që nuk varen prej vullnetit të tyre, nevojat minimale të fëmijës për strehim, ushqim, veshmbathje dhe edukim, ofrohen nga shteti, kur kjo kërkohet prej tyre, sipas legjislacionit në fuqi për shërbimet e kujdesit shoqëror.

Me vendimin nr.236 të KM, datë 19.3.2020 “ Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19” qeveria miratoi planin e masave që do të zbatoheshin për ofrimin e shërbimeve sociale shtresave në nevojë.

Vendimi parashikonte se shtresa në nevojë do të konsideroheshin:

- personat/familjet, të cilët nuk kanë familjarë të aftë për punë në njësinë administrative ku jetojnë, dhe që bëjnë pjesë në grupet, si më poshtë vijon:*
 - Familjet/individët në nevojë, përfitues të ndihmës ekonomike;*
 - Personat me aftësi të kufizuara;*
 - Personat, të cilët përfitojnë pension pleqërie.*

b) *personat, të cilët, pavarësisht përbërjes familjare dhe vendndodhjes së saj, bëjnë pjesë në grupet, si më poshtë vijon:*

i. Familjet/individët në nevojë, të cilët janë të pastrehë;

ii. Familjet që kanë humbur banesën për shkak të tërmetit.

Kështu, nga pikëpamja normuese, qeveria ngriti strukturat dhe përcaktoi procedurën si dhe mënyrën e ofrimit të shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, pjesë e përfituesve të së cilës janë edhe fëmijët e këtyre familjeve.

Pavarësisht parashikimeve të kryera nga strukturat shtetërore, të dhënat e grumbulluara tregojnë se, familjet në nevojë kanë vijuar të drejtohen në institucione të ndryshme për të kërkuar asistencë sociale pasi; ose nuk kanë përmbushur kushtet e përcaktuara për të përfituar nga asistencë sociale, ose ndihma e ofruar nuk ka qenë e mjaftueshme për të përballuar gjendjen familjare.

Në lidhje me cënimin e të drejtës për përfituar nga shërbimi i kujdesit shoqëror pranë KMPDF janë trajtuar 15 (pesëmbëdhjetë) raste, shumica prej të cilave janë ndërmarrë me iniciative të KMPDF.

Rezulton se **KMPDF i është drejtuar për shpjegime Bashkive respektive, si dhe NJMF-ve**, për trajtimin e rasteve, nisur nga interesi më i lartë i fëmijëve, si dhe në mbështetje të nenit 51, të ligjit nr.18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, dhe të udhëzimit nr.253, datë 10.4.2020, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, “Për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore për arsye të epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”.

KMPDF vëren se, referuar parashikimeve ligjore të sipërpërmendura, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës, duhet të identifikojnë në mënyrë proaktive rastet e fëmijës në rrezik dhe në nevojë për mbrojtje, nëpërmjet vizitave periodike në terren dhe në familjen e fëmijës në rrezik, komunikimit me profesionistët nga sektori i arsimit, shëndetësisë dhe rendit, të cilët kanë kontakte me fëmijët, të bëjnë vlerësimin e nivelit të rrezikut të çdo rasti të referuar dhe të identifikuar të fëmijës në nevojë për mbrojtje, të bashkëpunojnë dhe të shkëmbejnë informacion, për menaxhimin e rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje, me çdo strukturë përgjegjëse shëndetësore, arsimore, policore, të prokurorisë dhe të gjyqësorit, në nivel qendror dhe vendor, si dhe me shoqërinë civile, duke ruajtur të dhënat personale të fëmijës.

Rastet e trajtuara nga SMPDF janë referuar duke mundësuar kështu vijimësi në përkujdesjen sociale të fëmijëve dhe familjeve të tyre nga ana e NjMF-ve dhe autoriteteve të qeverisjes vendore përgjegjëse duke vijuar me monitorimin e rasteve edhe pasi mbështetja fillestare nga organet kompetente ishte kryer.

IV - IV Mbrojtja nga të gjitha format e dhunës

Neni 23, i ligjit nr.18/2017 përcakton të drejtën e fëmijës për t'u mbrojtur ndaj të gjitha formave të dhunës, duke përfshirë abuzimin, neglizhimin, shfrytëzimin, trafikimin, pengmarrjen, pornografinë, abuzimin seksual, si dhe forma të tjera të dhunës, pavarësisht vendit ku kryhet.

Në lidhje me cënimin e të drejtës për mbrojtjen nga dhuna, pranë SMPDF janë administruar 2 raste, një prej të cilave mori shkas nga transmetimi televiziv i dhunimit të një djalë 15 vjeçar nga ana e forcave të policisë në Tiranë.

Rekomandimi i AP për trajtimin e rastit në SMPDF të cilat ua ka adresuar institucioneve shtetërore përgjegjëse si: Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, Prokurorisë së Rrethit Gjuqësor Tiranë dhe Autoritetit të Mediave Audiovizive, ka qënë si më poshtë:

- Marrja e masave për largimin përgjithmonë nga rradhët e punonjësve të Policisë së Shtetit, të punonjëve, që ushtruan dhunën e pajustificuar ndaj minorenit me iniciale S.Ç.
- Marrja e masave nga organi i prokurorisë, për fillimin e ndjekjes penale ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit, për veprën penale “Kryerja e veprimeve arbitrare” sipas nenit 250, të ligjit nr.7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i RSH-së”, të ndryshuar, për dëmin fizik dhe moral, shkaktuar ndaj një të mituri me iniciale S.Ç., në kuptim të pikës 5, të nenit 3, të ligjit nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.
- Marrja e masave, për një bashkërendim më të konsoliduar, eficient dhe të realizuar në kohë e konkret, ndërmjet strukturave përgjegjëse në nivel vendor, për garantimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës S.Ç.
- Marrja e masave, për organizimin e trajnimeve dhe kualifikimeve të vazhdueshme për punonjësit dhe profesionistët e tjerë, që punojnë në fushat e rendit dhe sigurisë publike, për edukimin mbi/rreth të drejtave të fëmijës.
- Marrja e masave, për hartimin e procedurave standarde operative për punonjësit e Policisë së Shtetit, për qasjen e tyre kundrejt fëmijëve në përputhje me standardet ndërkombëtare të adresuara për këtë qëllim, si dhe aktet ndërkombëtare e kombëtare në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.
- Marrja e masave, për kryerjen e testeve të gjendjes psiko-sociale dhe emocionale në mënyrë të herëpashershme, të të gjithë punonjësve të Policisë së Shtetit dhe profesionistëve, që punojnë apo janë në kontakt të drejtpërdrejt me fëmijët.
- Marrja e masave, nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, për monitorimin në vijë të punës së strukturave shtetërore përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi, për vendosjen dhe ekzekutimin e sanksioneve administrative, në rast të mospërbushjes së detyrimeve ligjore nga këto struktura.
- Marrja e masave, për ndryshimin e legjislacionit që rregullon veprimtarinë e mediave audiovizive, për përcaktimin e rregullave më të detajuara, për sa i përket trajtimit të çështjeve të abuzimit/dhunës tek të miturit.

Rasti i dyte i trajtuar, ishte dhunimi një fëmijë të mitur gjatë kohës së karantinës së imponuar. Kjo solli në pah një prej problematikave të sjella në vëmendje që prej imponimit mbarë botëror të masave shtrënguese nga organizata të ndryshme me fokus në të drejtat e fëmijëve.

Referuar të dhënave të United Nations Children's Fund (UNICEF)¹⁶, tre të katërtat e fëmijëve të moshës 2-4 vjeç vuajnë nga ndonjë formë agresioni fizik ose psikologjik nga ata atë cilët përkujdesen për ta.

I tille ishte edhe rasti i dhunës ndaj një të mituri 3-vjeçar, nga bashkëjetuesi i nënës së tij. Ndër mjaft probleme të tjera kjo dëshmon se, masat e ndërmarra për karantinim të popullatës, me qëllim parandalimin e COVID-19, nxitën/ndikuan në problemet dhe mirëqenien e fëmijëve në familje dhe shoqëri.

KMPDF ka adresuar në bashkinë përkatëse marrjen e masave për monitorimin e vazhdueshëm të situatës së të miturit për t'i siguruar gëzimin e standardeve më të larta të mundshme të shëndetit, trajtimit e rehabilitimit fëmijës.

IV-V- E drejta për pushim dhe argëtime kulturore e sportive

“Fëmija ka të drejtë të pushojë, të argëtohet, të praktikojë lojëra dhe veprimtari çlodhëse dhe të marrë pjesë lirish në jetën kulturore, artistike e sportive, në përshtatje me moshën e tij”¹⁷. Edhe pse nuk mund të kategorizohet si e drejtë absolute, duhet pasur në vëmendje që, aktiviteti fizik, lojrat dhe argëtimi i fëmijëve janë pjesë absolutisht e pandarë e formimit të njeriut të shëndetshëm fizikisht dhe psikologjikisht dhe të përshtatshëm për të jetuar në komunitet. Në kontekstin e një realiteti normal, një ndër sfidat e mijëvjeçarit të ri ka qenë padyshim edhe angazhimi sportiv, social e kulturor i fëmijëve të cilët çdo ditë e më shumë e gjejnë veten pjesë të një realiteti virtual i cili përthith energjinë dhe vëmendjen e tyre.

Mbyllja dhe shtrëngimi i ngujimit të fëmijëve në ambiente të brendshme prej ku edhe duhet të plotësonin të gjithë nevojat psiko-fizike ka sjellë një trafik të shtuar të përdorimit të internetit dhe probleme të shëndetit mendor tek fëmijët.

Në studimin e bërë nga Urdhri i Psikologut në lidhje me raportimin e të dhënave të ndihmës kërkuar nëpërmjet linjës telefonike “psikologët shqiptar online”, një përqindje të konsiderueshme të telefonuesve e (18%) zënë të miturit, nga moshë 10-17 vjeç. Numri i tyre është shtuar për shkak të mungesës së fashave të orareve për ta, për të dalë nga banesa, frika nga COVID, problematika të hasura me mësimin online, mungesa e kontakteve të drejtpërdrejta sociale të domosdoshme për një adoleshent, të cilat i janë mbivendosur problematikave të moshës.¹⁸

16. https://www.unicef.org/publications/files/Violence_in_the_lives_of_children_and_adolescents.pdf

17. neni 19, ligji nr.18/2017 “Per te drejtat dhe mbrojtjen e femijes”

18. Nisma “Psikologët shqiptarë online”, index I shërbimit psikologjik papagesë. Periudha 23 Mars- 10 Maj 2020. Nr.117 prot. Dt.13.5.2020

Sa më sipër vihet re se masat shtrënguese kanë pasur impakt të konsiderueshëm në mirëqenien psikologjike të fëmijëve.

IV-VI- Liria e jetës private

Fëmijës i garantohet respektimi i jetës private, familjare, banesës, korrespondencës dhe mbrojtja nga cënimi i paligjshëm i moralit dhe i dinjitetit të tij.

Privatësia e fëmijës mbrohet në të gjitha situatat, përfshirë ato brenda familjes, institucioneve të kujdesit shëndetësor, shoqëror e të shërbimeve. Kjo e drejtë përfshin privatësinë e marrëdhënieve e të komunikimeve me të tjerët, të drejtën për këshillim konfidencial, kontrollin e aksesit në informacionin që ruhet për fëmijët në dosjet përkatëse.

Pranë institucionit të AP është administruar ankesa e Qendrës për Progres Rinor, Kukës për problemin e shkeljes së të dhënave personale dhe privacisë të fëmijëve gjatë zhvillimit të mësimin online.

Qendra për Progres Rinor në Kukës, ka paraqitur pranë AP një ankesë objekti i së cilës ishte “...*publikimi i të dhënave dhe imazheve të nxënësve në website-t e shkollave në internet pa filtra sigurie*”. Ndonëse qëllimi i përdorimit të teknologjisë dhe internetit në këtë situatë është i mirë, mosrespektimi i rregullave për përdorimin e sigurt të internetit është kthyer në një problem serioz, përse i përket ruajtjes së privatësisë së fëmijëve në internet. Pothuajse çdo shkollë 9-vjeçare dhe e mesme në Kukës publikonte në mënyrë të vazhdueshme imazhe dhe të dhëna për nxënësit, pa përdorur filtra sigurie, përpara se t'i publikojnë në internet...”.

AP rezultoi t'i jetë drejtuar me sugjerimet/rekomandime katër Drejtorive Rajonale Arsimore të vendit: Durrës, Korçë, Fier dhe Lezhë duke rekomanduar dhe sugjeruar mbrojtjen e fëmijëve/ nxënës të arsimit para universitar gjatë procesit të mësimin online në periudhën e pandemisë nëpërmjet :

- marrjes së masave për verifikimin e situatës, në të gjitha shkollat, për të rritur ndërgjegjësimin për rreziqet e internetit të pasigurt e të pakontrolluar, ndaj fëmijëve.
- ruajtjes së privatësisë dhe imazheve të fëmijëve-nxënës gjatë procesit të të mësuarit online, dhe mbajtjen e lidhjeve mes mësuesve dhe prindërve në këtë kontekst, si konsideratë mjaft thelbësore.
- forcimit të punës për përsosjen e marrëdhënieve mësues-fëmijë/nxënës: marrëdhënie bashkëpunimi për arritjen e realizimit të objektivave të përbashkëta, ku një ndër të rëndësishmit është edhe parandalimi i çdo forme shkeljeje të të drejtave të tyre, edhe në këtë periudhë të pazakontë pandemie.
- forcimit të sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të respektimit të të drejtave të fëmijëve dhe vendosjen e të drejtave të fëmijëve në zemër të vullnetit të mësimitdhënies.
- aplikimit të një pedagogjie të bazuar në të drejta, për të siguruar, që fëmijët dhe të rinjtë, të mësojnë në një mjedis ku respektohen këto të drejta.

REKOMANDIME

1. Sugjerime për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve në këtë situatë pandemie, drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Këto kushte të vetëizolimit të familjeve në shtëpi, sollën edhe qasjen e re, atë të të punuarit online nga shtëpia për shumë institucione shtetërore, në funksion të përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësisë, brenda fushës së veprimtarisë së tyre dhe në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

- marrjen e masave nga ana e qeverisjes vendore, për identifikimin e familjeve, që në përbërjen e tyre kanë fëmijë, që jetojnë në kushte të vështira sociale-ekonomike, për të bërë të mundur mbështetjen e tyre me paketa ushqimore, paketa dizifektatësh, ilaçe e materiale të tjera të higjenes vetjake, etj, në përputhje me standardet e OBSH, si dhe shpërndarjen e tyre në mjediset, ku janë vetëizoluar këto familje;
- marrjen e masave nga qeverisja vendore, për dizifektimin e mjediseve të institucioneve të përkujdesit shoqëror rezidencial, të cilat ofrojnë shërbime sociale për fëmijët në nevojë, fëmijët me aftësi të kufizuara, si dhe institucionet e privimit të lirisë që trajtojnë të miturit në konflikt me ligjin;
- marrjen e masave nga bashkitë përkatëse, për sistemimin në mjedise të përshtatshme për fëmijët në situatë rruge, të cilët janë dhe target grupi më i prekur dhe me i ekspozuar ndaj infektimit me COVID-19;
- marrjen e masave në krijimin e kushteve për realizimin e një vaksinimi të sigurtë të të miturve, sipas kalendarit të paracaktuar të vaksinimit.

2. Sugjerime lidhur me vendosjen e kufizimit moshor në fashën orare, drejtuar Agjensisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.

Gjatë periudhës së lehtësimit të masave kufizuese të lëvizjes së lirë, vendosja e kufizimit moshor në fashën orar, cenon dhe prek të drejtat e fëmijës dhe, për më tepër mospërfshirja e fëmijëve të grupmoshës nga 10-18 vjeç në asnjë fashë orari, dhunon parimet kryesore të të drejtave të fëmijëve.

Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Fëmijës” dhe ligji nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” kanë përkufizuar qartësisht kuptimin e termit “fëmijë” siaps të cilit, çdo person nën moshën 18 vjeç është fëmijë.

Ky ligj ka për qëllim ndër të tjera, pikërisht, garantimin e mirëqenies dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijës, duke promovuar e mundësuar zhvillimin e tyre në shoqëri, ndihmën

dhe përkujdesin efektiv për fëmijën, pa diskriminim. Marrja e masave për t'i siguruar fëmijës ushtrimin e të drejtave, në përputhje me zhvillimin e personalitetit, bazuar në interesin më të lartë të tij është parësor në çdo vendimmarrje që afekton ata drejtpërdrejt ose jo.

Duke mirëkuptuar, krijimin e mundësisë për lëvizje, domosdoshmërisht duhet të vlerësohen dhe merren parasysh të drejtat e fëmijëve. Dhe, për më tepër, fëmijët kanë të drejtë të gëzojnë, mbi bazën e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, një nivel jetese të përshtatshëm për zhvillimin e tyre fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror.

Në këtë situatë të vështirë, krijuar prej COVID-19, është detyrë e të gjithëve së bashku, t'u garantojmë fëmijëve mirëqenie, emocionale, fizike, sociale e materiale, duke u kujdesur për ta, duke marrë masa e nevojshme për ushtrimin e të gjitha të drejtave, nga të gjithë fëmijët, në barazi pa diskriminim.

3. Sugjerimet për mbrojtjen e fëmijëve/nxënës të arsimit parauniversitar gjatë procesit të mësimin online në periudhën e pandemisë

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës parasheh, se arsimit duhet t'ju sigurojë fëmijëve zhvillimin e njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave, në mënyrë të pavarur e të gjithanshme në drejtim të përgatitjes për të forcuar aftësitë për jetën, të orientuara drejt përbushjes së të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe të fëmijëve në veçanti, për të nxitur një kulturë që respekton, mbrojt dhe promovon vlerat e të drejtave të njeriut.

Një ndër praktikatat e mira të punës është monitorimi online i shqetësimeve dhe ankesave që paraqesin qytetarët, kryesisht kategoritë më në nevojë, si dhe për të mbështetur sadopak kategoritë më të prekura, siç janë fëmijët.

Në këtë situatë pandemie, një nga sfidat e të gjitha institucioneve arsimore, për të përbushur me sukses detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, është padyshim edhe procesi i mësimin online, që po u zhvillua anembanë vendit, si dhe në rang global.

Në vijim të vlerësimit të nevojave aktuale për mbarëvajtjen e procesit të mësimin online, sugjerohet marrja e masave konkrete, në përputhje me problematikat e evidentuara gjatë kësaj periudhe dhe në funksion të situatës. Për më tepër, si rezultat i masave të kufizimit, fëmijët qëndrojnë gjithnjë e më shumë në internet dhe, kuptueshëm, në varësi të mediave sociale, për qëllime të edukimit ose edhe argëtimit, apo të tjera me karakter social (ruajtja e kontakteve me miqtë), etj. Pa diskutim që prindërit dhe kujdestarët e tyre ligjorë, që kujdesen për fëmijët në kushtet e izolimit, duhet të mbështeten në përballimin e sjelljes së tyre emocionale gjatë kësaj situatë të emergjencës COVID-19. Disa nga rreziqet kryesore ndaj fëmijëve-nxënës, janë rreziqe të përdorimit të papërshtatshëm të teknologjisë, mungesa e privatësisë, ndarja ose postimi i informacionit të rremë për veten ose të tjerët. Këto lloje sjelljesh e vendosin në rrezik privatësinë e tyre.

Në këtë kuptim, institucionet arsimore duhet të rrisin përpjekjet për komunikim, të cilat duhet të synojnë rritjen e ndërgjegjësimit të të rriturve, për masat që ata mund të ndër marrin për

të mbrojtur fëmijët e tyre, ndërkohë që lundrojnë e mësojnë në internet. Të mësuarit përmes platformave online dhe aksesit në internet, si dhe transmetimi i mësimit online në një ndër kanalet e Televizionit Publik Shqiptar, është një qasje e re e të nxënësve dhe edukimit, për të gjithë nxënësit në territorin e RSH-së.

Sigurisht, është e rëndësishme që të vepohet në mënyrë parandaluese, duke rritur ndërgjegjësimin e tyre mbi rreziqet e mundshme dhe pasojat afatgjata të ndarjes së informacionit personal në internet. Fëmijët duhet po ashtu, të jenë në gjendje të identifikojnë, kuptojnë dhe përballen me përmbajtje të dëmshme. Për më tepër, duhet të informohen më shumë mbi të drejtat e njeriut, përfshirë këtu të drejtën e shprehjes dhe të drejtën për privatësi, por edhe të drejtat e të tjerëve, të cilat duhet t'i respektojnë dhe të tregojnë kujdes për të mos i dëmtuar. Privatësia është ngushtësisht e lidhur me sigurinë. Privatësia online është një nga çështjet më komplekse etike dhe ligjore, që kanë lidhje me internetin.

Nevojat dhe shqetësimet e të miturve për arsim, janë në të njëjtën linjë me domosdoshmërinë e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, dhe kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme, kjo dhe në zbatim të parimit të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijëve.

Detyrimet e Konventës së Kombeve të Bashkuara “Për të drejtat e fëmijës” duhen zbatuar për të gjitha aspektet e jetës së fëmijëve, duke filluar nga mbijetesat e mirëqenia e tyre, zhvillimi dhe mbrojtja e tyre, dëgjimi i zërit të tyre, por edhe për hapësirat ku banojnë, duke përfshirë këtu edhe mjedisin digjital.

Ndërsa kjo gjeneratë e fëmijëve dhe të rinjve, sot me të vërtetë jeton në epokën digjitale, ne përballemi me një sfidë të rëndësishme: të sigurojmë që të drejtat e tyre të mbrohen e respektohen në botën online¹⁹.

Në mënyrë që, procesi i mësimit të fëmijëve të kryhet në një mjedis të qetë, në kushtet e pandemisë dhe të izolimit, si një qasje e re për të gjithë, duke garantuar të drejtën e tyre për t'u arsimuar, nëpërmjet mësimit online, mbështetur në interesin më të lartë të fëmijës, në zbatim dhe të ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, sugjerimet janë si me poshtë:

- marrjen e masave për verifikimin e situatës, në të gjitha shkollat, për të rritur ndërgjegjësimin për rreziqet e internetit të pasigurt e të pakontrolluar, ndaj fëmijëve.
- ruajtjen e privatësisë dhe imazheve të fëmijëve-nxënës gjatë procesit të të mësuarit online, dhe mbajtjen e lidhjeve mes mësuesve dhe prindërve në këtë kontekst, si konsideratë mjaft thelbësore.
- forcimin e punës për përsosjen e marrëdhënieve mësues-fëmijë/nxënës: marrëdhënie bashkëpunimi për arritjen e realizimit të objektivave të përbashkëta, ku një ndër të rëndësishmit është edhe parandalimi i çdo forme shkeljeje të të drejtave të tyre, edhe në këtë periudhë të pazakontë pandemie.

19. Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës CM / Rec (2018) mbi Udhëzimet për respektimin, mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtave të fëmijës në mjedisin dixhital CM/Rec (2018)7 4 Korrik 2018

- forcimin e sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të respektimit të të drejtave të fëmijëve dhe vendosjen e të drejtave të fëmijëve në zemër të vullnetit të mësimdhënies.
- aplikimi i një pedagogjie të bazuar në të drejta, për të siguruar, që fëmijët dhe të rinjtë, të mësojnë në një mjedis ku respektohen këto të drejta.

Është detyrë e të gjithëve së bashku, që të përpjekjet të orientohen në drejtim të forcimit të punës, për të ndërtuar një marrëdhënie bashkëpunimi për arritjen e realizimit të objektivave të përbashkëta, për një proces mësimdhënieje online sa më cilësor, që siguron një shtrat të shëndetshëm për funksionimin e metodave aktive krijuese në edukim e arsimim.

4. Sugjerimet drejtuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për fëmijët që nuk mund të ndjekin mësimin online, pasi nuk kanë akses në internet apo pajisjet e nevojshme, në familjet e tyre.

Nisur nga rastet e evidentuara për zhvillimin e platformës së mësimin on line, edhe nga njoftimet mediatike të rasteve të veçanta, se ky proces nuk po zhvillohet në mënyrë të drejtë, anekënd vendit, kjo për shkak të mungesës së kushteve objektive, siç është mungesa e internetit, ose aksesit që fëmijët mund të kenë në pajisjet e teknologjisë: kompjuter apo laptopë, apo dhe celularë.

Të mësuarit përmes platformave online dhe aksesit në internet, si dhe transmetimi i mësimin online në një ndër kanalet e Televizionit Publik Shqiptar, është një qasje e re e të nxënësve dhe edukimit, për të gjithë nxënësit në territorin e RSH-së. Nevojat dhe shqetësimet e të miturve për arsim, kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme, kjo dhe në zbatim të parimit të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijëve.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë duhet të kushtojë vëmendje të shtuar për t'i dhënë zgjidhje e gjetjen e alternativave për fëmijët që nuk mund të ndjekin mësimin online, pasi nuk kanë akses në internet apo pajisjet e nevojshme, në familjet e tyre. Gjithashtu, MASR duhet të evidentojë dhe të hartojë një strategji e cila do të mundësonte mësimin alternativ të grupeve të ndryshme duke mbajtur në konsideratë vendndodhjen dhe problematikat sociale të fëmijëve që preken nga këto masa kufizuese. Në pamundësi të pajisjes me mjete mësimore digjitale nga ana e MASR të merret në konsideratë vijimi i zhvillimit mësimor me këtë grup fëmijësh, duke zbatuar rregullat e distancimit fizik anticovid-19.

Disa nga grupet më të cënueshme në Shqipëri, si ato të minoritetit Rom, familjet që jetojnë në varfëri ekstreme, familjet në zonat rurale larg qendrave të mëdha të banuara etj., pavarësisht kushteve të veçanta apo gjendjes ekonomike të familjeve të tyre, të gjithë fëmijët e tyre janë të barabartë në të drejta.

Duhet përgëzuar armata e të gjithë mësuesve e personelit pedagogjik të arsimit parauniversitar publik anekënd vendit për përkushtimin, solidaritetin dhe gjetjen e zgjidhjeve për qasjen sa më shumë të dijes e mësimave tek nxënësit.

MASR në bashkëpunim me institucionet e saj të varësisë të shqyrtojë edhe modele që po zbatohen nga vende të ndryshme, për të gjetur zgjidhjet dhe qasjet më efektive ndaj problematikave që evidentohen ditë pas dite.

Kur pandemia të jetë nën kontroll, shtetet do të duhet të dyfishojnë përpjekjet e tyre për të zgjidhur mangësitë e kahershme në ligj, praktikë dhe ligjërime, të cilat janë aq të dëmshme për dinjitetin dhe të drejtat e njeriut²⁰.

20. <https://www.coe.int/en/web/commissioner/-/challenges-to-human-rights-have-intensified-in-europe>, Deklarata e Komisioneres se KiE Dunja Mijatovic, 21.4.2020.